



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 16.10.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Frashër Krasniqi, Sami Kurteshi, Korab Sejdiu, Igor Simiq, Bilall Sherifi, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Mungoi: Arben Gashi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Mirjeta Duraku, “Kosova Press”; Arbëresha Shpati, Klan Kosova; Valmira Saraçi, KTV; Blerta Bejtullahu, Shaban Murturi dhe Edita Kusari EUSR/EUO; Erblina Sejdiu, praktikante; Rreze Hoxha, GLPS; Besiana Dauti, “Ekonomia online”; Melodika Arbrashi, KDI; Sanije Berisha, OSBE; Majlindë Sinani- Lulaj, Hilmi Jashari dhe Suzana Gashi, IAP.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Nur Çeku, Mirlinda Kolgeci, Fatbardha Boletini dhe Hana Bajraktari

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-096 për Referendum;
3. Shqyrtimi i Raportit të Avokatit të Popullit në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale;

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-096 për Referendum

Kryetarja paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 06/L-096 për Referendum dhe tha se e drejta e referendumit është e drejtë e pakontestueshme dhe është dashur që Kosova ta ketë shumë kohë më parë. Po ashtu, problemet me këtë draft janë jashtëzakonisht të mëdha, sepse ky ka qenë draft që i është dhënë aktivistëve, për të dhënë vërejtje dhe komente, pra është draft fillestar, në të cilin ka çështje që kanë mbetur si komente. Më tej, znj. Haxhiu tha se është gabim që Kosova nuk ka referendum ku qytetarët do të duhej të vendosin për demarkacionin duke pohuar se ka shumë vërejtje në lidhje me këtë projektligj të cilat janë përmbajtjesor.

Frashër Krasniqi, sqaroi rreth hartimit të këtij projektligji, duke pohuar se ky projektligj nuk është hartuar nga Lëvizja Vetëvendosje, por është bërë prej një grupi ekspertësh, të cilët kanë kërkuar të mbeten anonim në koordinim me z. Faton Topalli dhe e ka përkthyer znj. Shqipe Pantina. Sipas z. Krasniqi, janë dy deputetë që edhe brenda Lëvizjes Vetëvendosje, e kanë bërë punën më të madhe, sa i përket pjesës së Lëvizjes Vetëvendosje. Pjesa përmbajtjesore e draftit është bërë ndërmjet bashkëpunëtorëve, Faton Topallit dhe Shqipe Pantinës. Më pas, tha se nuk mendoj që është e rëndësishme dhe të bëhet temë se kush e ka bërë draftin, por, as kush e ka propozuar ligjin, sepse nëse duam ta çojmë vendin tonë përpara, kjo nuk ka rëndësi. Edhe ky projektligj ka gabime dhe nuk po themi që të mbetet kështu siç është, sepse të gjitha ligjet që vijnë, ndryshohen dhe plotësohen me amendamente në komision dhe pastaj kalojnë ose refuzohen, varësisht qysh ekziston vullneti i partive politike, por mos të bëhet temë vetëm pse e ka propozuar PSD-ja.

Sami Kurteshi, tha se nuk ka rëndësi kush ka punuar në këtë draft, duke pohuar se në parim, një ligj për referendumin është i domosdoshëm. Problemi është tek teksti, sepse si i tillë, si është dorëzuar, ka mangësi shumë të mëdha, sa mund të kërkoj një ndryshim shumë të madh dhe mund të kalojë edhe përqindjen e lejuar. Sipas z. Kurteshi, nuk është me rëndësi se kush e ka propozuar këtë projektligj, duke thënë se ka probleme edhe sa i përket përkufizimeve edhe në aspektin e sasisë ose numrave, sepse ka të bëjë edhe me numrat se çfarë referendumit është, kush e inicion, sa nënshkrime kërkohen, pra ka nevojë shumë gjëra të ndryshohen dhe të rregullohen. Më tej, theksoi se është i interesuar që të bëhet një ligj i mirë dhe ky ligj të kalojë sa më shpejt me amendamentet që mund të propozohen, sepse Kosova ka nevojë për një ligj të referendumit, ku e parasheh edhe Kushtetuta.

Shkumbin Demaliaj, tha se është hera e parë që është i kënaqur që në Kuvendin e Kosovës vjen një projektligj i tillë. Sipas z. Demaliaj, pavarësisht kush ka punuar në këtë projektligj apo a është i përgatitur mirë, e rëndësishme është që me këtë ligj, popullit të Kosovës i jepet e drejta të

vendos për fatin, pavarësisht inateve politike që mund t'i kenë subjektet politike. Edhe pse i vonuar, ky ligj duhet të jetë pjesë e legjislacionit tonë në fuqi, sepse e dimë që me rezolutën 1244 dhe me kornizën Kushtetuese, iu ka shkelur kjo e drejtë popullit të Kosovës, që të vendosë për fatin e saj, me referendum. Në fund, tha se ne duhet ta nxjerrim këtë ligj dhe të jetë sa më mirë i ndërtuar, përkundër atyre të metave që mund të ketë, por e rëndësia e këtij projektligji është shumë e madhe, ku populli i Kosovës do të vendosë vetë për fatin e tij.

Hajdar Beqa, tha se ne si Kuvend i Republikës së Kosovës, bazuar edhe në kompetencat e Kuvendit, me nenin 65, paragrafi 3 të Kushtetutës, na jep të drejtën mbi Ligjin për Referendum. Sipas z. Beqa, ky ligj është i vonuar dhe duhet të harmonizohet me Kushtetutën, sepse ka disa çështje që nuk mund të rregullohen edhe pa 2/3 e komuniteteve t'i rregullojmë, por megjithatë, ne në parim, pajtohemi që të vazhdojmë përpara me ligjin. Më pas, deputeti Beqa e përgëzoi PSD-në për këtë projektligj dhe tha se duhet të ecim përpara, por që në të njëjtën kohë të bëhen edhe ndryshime, sepse ligji ka edhe mangësi. Po ashtu, z. Beqa propozoi që komisioni të marrë këtë nismë, për ta çuar përpara si komision, në mënyrë që të bëhet një ligj më i kompletuar. Në fund, tha se e në këtë fazë e përkrah dhe do të kontribuoj edhe si anëtar i grupit të punës, për këtë projektligj, sepse është më se i domosdoshëm për rrethanat që po kalon Republika e Kosovës.

Korab Sejdiu, tha se propozuesi na ka vënë para një dileme, duke propozuar këtë projektligj, sepse në njërën anë projektligji adreson një çështje që ndër të tjera përmenden edhe nenet 2.1 edhe 65.3 të Kushtetutës, si dhe adreson një çështje të vonuar. Sipas z. Sejdiu, ky dokument nuk është i prezantuar mirë, sepse përveç gabimeve teknike, nuk do të duhej që Kuvendi të pranojë një dokument, në këtë formë, duke krahasuar edhe ligjet e vendeve tjera për referendum sesi e kanë të rregulluar dhe sesi do të duhej adresuar. E di që kemi mundësi për të angazhuar ekspertë, mirëpo ato mundësi janë të kufizuara. Më pas, tha se kjo duhet të adresohet te një grup i njerëzve, që e njohin mirë këtë lëmi, sepse ne si komision, me përjashtim të z. Kurteshi që paska punuar në këtë hartim, ne të tjerët nuk kemi punuar ndonjëherë në hartimin e një legjislacioni për referendum, që është një lëmi shumë e ndërlikuar. Po ashtu, z. Sejdiu theksoi se PSD-ja do të duhej të tërhiqej nga ky projektligj, duke propozuar që ta hartojnë një grup ekspertësh, për të hartuar këtë projektligj, të cilët janë më të mirë dhe pastaj të propozohet sërish. Nëse insistohet prej komisionit që ky projektligj të shkojë përpara, atëherë të sigurohemi që kemi mbështetje të mjaftueshme, jo vetëm të brendshme, por nga ekspertë të jashtëm, të cilët do të vijnë dhe do të na ndihmojnë. Duke pasur parasysh ngarkesën që e kemi si komision dhe dështimin e Ministrisë së Drejtësisë që të hartojnë ligje, që neve të na japin mundësinë që vetëm t'i rishikojmë dhe jo t'i hartojmë prej fillimit, qysh po na ndodh shpesh, atëherë nuk e di sa kemi kapacitet ta bëjmë këtë në mënyrë vetjake. Në fund, tha se duhet të marrim një mbështetje profesionale.

Bilall Sherifi, tha se ne duhet ta dimë që projektligji ynë për referendum nuk mund të jetë si i secilit shtet për referendum. Çdo ligj lind nga Kushtetuta dhe Kushtetuta jonë kufizon shumë gjëra, sepse ne nuk mund të ndryshojmë Kushtetutën me referendum, madje nuk mund të ndryshojmë as Kushtetutën në Kuvend, para se të marrim miratimin nga Gjykata Kushtetuese, në lidhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Madje nuk mund të ndryshojmë Kushtetutën as në Kuvend, para se të kemi marrë miratimin nga Gjykata Kushtetuese, për faktin se Kushtetuta jonë buron nga Pakoja e Ahtisarit. Ne duhet ta marrim parasysh këtë fakt ,dhe nëse nisemi me këtë parim, atëherë del që kryesisht, mund të bëjmë referendume konsultative jo-obliguese. Po ashtu, z. Sherifi tha se neve na nevojitet një ligj për referendum, i cili bazohet në Kushtetutën tonë dhe jo në kushtetutat tjera. E mbështes z. Beqa që kjo le të jetë një nismë e komisionit. Kjo le të jetë si bazë për të filluar dhe të shohim kapacitetet tona financiare, si komision, po ashtu, pse jo edhe

të Qeverisë dhe të angazhojmë ekspertë që do të na e binin neve lëndën e parë si komision dhe pastaj ne do të mund të jepnim mendimin dhe këndvështrimin tonë edhe nga këndvështrimi i partive politike, të cilat përfaqësojmë, grupeve parlamentare, të cilat përfaqësojmë. Në fund, tha se dëshiron që kjo çështje të shtyhet përpara, por duke pasur parasysh të gjitha këto që u thanë madje edhe nga vetë z. Krasniqi, që ka nevojë për ndërhyrje.

Sami Kurteshi, tha se ata njerëz që kanë punuar në tekst, janë përpjekur të bazohen në Kushtetutë. Kushtetuta jonë jep hapësirë që të kemi një ligj për referendumin. Ne kemi edhe referendimet lokale. Kryesisht, ky tekst është punuar duke u bazuar në Kushtetutën e Zvicrës, sepse nuk ka ligj të veçantë, duke dhënë sqarime për disa shtete sesi e kanë të rregulluar këtë çështje, p.sh. te rasti i Ukrainës, është edhe një opinion shumë i vlefshëm nga Komisioni i Venecias, në lidhje me praktikën e referendimit. Gjithashtu, tha se ka mundësi të punohet një ligj i mirë për referendumin dhe pajtohem me vërejtjet dhe mendoj se pa marrë parasysh këto mospajtime edhe PSD-ja është që të punohet dhe bashkëpunohet për këtë projektligj. Ne kemi mundësi të bashkëpunojmë dhe të angazhojmë ekspertë që i njohin mirë këto çështje. Ka mundësi që ta bëjmë një ligj të mirë dhe se a shkon në emër të komisionit apo të PSD-së, ajo ka pak rëndësi, por e rëndësishme është që të punohet në këtë ligj, të punohet një tekst i mirë, që të ketë më pak hapësirë për vërejtje. Në fund, tha se jam i gatshëm të punojmë bashkë me ata që i cakton komisioni.

Shkumbin Demaliaj, propozoi që t'i japim rrugë projektligjit dhe menjëherë të thërrasim një dëgjim publik, si komision, sepse ka ekspertë të mjaftueshëm të këtij lëmi. Njerëzit që e kanë hartuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës mbi 95% kanë qenë njerëz të Kosovës. Sipas z. Demaliaj, ata profesorë të vijnë në grupe të punës dhe t'iu bashkohen grupeve të punës dhe në një dëgjese publike mund të rregullohet kjo çështje. Në fund, theksoi se është pro një projektligji të tillë dhe të ndryshohet brenda kornizës ligjore të Republikës së Kosovës.

Frashër Krasniqi, tha se për PSD-në nuk është aspak e rëndësishme se kush po e inicion ligjin dhe nuk do ishte problem fare që ligji të kthehet në procedurën fillestare. Për Ligjin për Referendum ka dy vjet që po diskutohet në opinionin publik. Besoj që do të mund të arrinim që të krijojmë një grup të punës, shumë të mirë, që do ta vazhdojë më tutje modifikimin e këtij projektligji. Ka shumë hapësirë për modifikim në këtë ligj dhe nuk është versioni përfundimtar që do të duhej të kalonte, por vlera kryesore e këtij ligji është që të kalojë dhe të fillojë diskutimi i hartimit serioz i një ligji për referendum. Gjithashtu, z. Krasniqi tha se nëse e kthejmë në fazën fillestare, unë mendoj që kjo do të marrë shumë më shumë kohë dhe nuk do të jemi të sigurt që do të procedohet edhe për një kohë të gjatë. Andaj, do të qëndroj me propozimin që kjo të hidhet në votim, në komision, kështu siç është, jo pse jam kundër ndryshimit, jo pse domosdo do të doja që PSD-ja të jetë nismëtare, por vetëm për arsye kohore që të kalojë ligji dhe ta kemi në rend të ditës dhe pastaj ta rregullojmë si komision, t'i përfshijmë krejt ekspertët. Më pas, tha se që sot, nëse është e mundur proceduralisht, nëse është e nevojshme e nënshkruaj që këtë projektligj e inicion komisioni. Në fund, tha se e rëndësishme është që ky ligj, pas dy vjet diskutimi, le të përfshihet dhe të ecë përpara, pastaj e modifikojmë sipas propozimeve të të gjithëve.

Kryetarja theksoi se, natyrisht, ne mund të angazhojmë ekspertë, sepse këtë na e lejon edhe Rregullorja e Kuvendit. Na mbetet që ne të finalizojmë se cilët janë ekspertët.

Hajdar Beqa, tha se ne e përkrahim iniciativën e PSD-së, por kemi pasur mundësi që proceduralisht mos ta përkrahim. Pra, në pikën e rendit të ditës, kemi pasur mundësi që, si komision, të propozojmë për iniciativën e këtij projektligji.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni me **7 vota për, asnjë votë kundër dhe 1 votë abstenim**, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 06/L-096 për Referendum.

3. Shqyrtimi i Raportit të Avokatit të Popullit në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin e Avokatit të Popullit, në lidhje me organizimin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale dhe se ky raport është jashtëzakonisht profesional dhe adreson me vend problemin që kemi me votimin jashtë vendit, gjegjësisht cenimin nga e drejta ose thënë më saktë, mospërfshirjen e bashkatdhetarëve tanë në procesin zgjedhor në Republikën e Kosovës, duke krijuar procedura burokratike, siç i kemi aktualisht me legjislacionin në fuqi. Kohë më parë, është adresuar nevoja që kjo të mbetet në ambasada dhe konsullata, si zgjidhje më e mirë, në mënyrë që shumë bashkatdhetarë të marrin pjesë në zgjedhje parlamentare dhe lokale. Më tej, znj. Haxhiu ftoi Avokatin e Popullit, z. Hilmi Jashari, për të arsyetuar raportin e këtij institucioni, duke e pyetur se çfarë keni konsideruar që të bëjë komisioni në këtë drejtim.

Hilmi Jashari, tha se raporti analizon Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme të Kosovës, sa i përket pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përkatësisht bëhet fjalë për një vlerësim të Komisionit të Venedikut, i cili flet për sistemin zgjedhor. Në kuadër të kësaj, ne kemi bërë një vlerësim të ligjit tonë për zgjedhjet e përgjithshme dhe ato lokale. Në kuadër të kësaj analize, kemi hasur disa parregullsi të ligjit tonë, i cili nuk i trajton në pajtim me opinionet dhe me mendimet e Komisionit të Venedikut, që është mekanizëm i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, duke pohuar që ky është një prej mekanizmave më të fuqishëm në Komisionin e Venedikut dhe në Këshillin e Evropës, që jep mendime juridike për çështjen e të drejtave të njeriut, mirëpo edhe për sistemin zgjedhor, në këtë rast. Një pjesë e madhe e mërgimtarëve që jetojnë jashtë vendit, kanë pasur vështirësi dhe është paraqitur problem, disa herë, në zgjedhjet e kaluara. Pra, ne kemi konsideruar të japim një kontribut tonin, sa i përket kësaj analize, dhe thjesht, duke dhënë një mendim sesi do të duhej të rregullohej kjo çështje. Raporti në fjalë përmban tri rekomandime, të cilat adresojnë problemin për të cilin po flasim, duke u mundësuar qytetarëve të vendit tonë që këto votime t'i kryejnë nëpër përfaqësitë tona në ambasada apo në konsullata dhe jo nëpërmjet sistemit me postë, të cilin Komisioni i Venedikut e vlerëson si sistem të papërshtatshëm dhe të dobët. Po ashtu, duke rritur edhe transparencën e procesit zgjedhor dhe duke kërkuar nga komisioni që të publikojë numrin e votuesve jashtë vendit. Këto të gjetura, në bazë të analizës që kemi bërë, të cilat janë të përmbledhura në fund të rekomandimit me sugjerimin e vetëm që të shihet mundësia e plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme, ku mund të iniciohet nga ky komision. Në fund, tha se në anën tjetër, na obligon një dispozitë kushtetuese, e cila është ndër dispozitat më të fuqishme që i jep mandat Avokatit të Popullit, për të bërë vlerësimin e legjislacionit në fuqi, sa i përket pajtueshmërisë me standardet ndërkombëtare, përkatësisht me mekanizmat e Këshillit të Evropës.

Kryetarja pyeti: Në qoftë se keni bërë këtë analizë, a keni shifra të sakta, sa prej bashkatdhetarëve tanë e kanë shfrytëzuar të drejtën e votës në zgjedhjet e fundit? Sepse, duke pasur parasysh se thuhet se 30 % e qytetarëve tanë jetojnë jashtë vendit, sa herë që kemi pasur takim me bashkatdhetarë, shqetësimi kryesor i tyre kanë qenë procedurat burokratike të ushtrimit të së drejtës së votës.

Hilmi Jashari, tha se nuk mund të flas për shifra të sakta. Kemi bërë përpjekje, mirëpo ky ka qenë qëllimi që kemi futur edhe rekomandimin, në fund të këtij raporti, i cili kërkon një transparencë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sa i përket votuesve që jetojnë jashtë vendit, për të siguruar informacione më të besueshme për të drejtën që e shfrytëzojnë bashkatdhetarët tanë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pas reagimit tonë që kemi bërë dhe pas publikimit që kemi bërë, është pajtuar me rekomandimet tona, me përjashtim të kësaj që i referohet transparencës. Ata kanë dërguar një listë, në të cilën shfaqin një pasqyrë të pjesëmarrjes, mirëpo kjo gjatë kohës së zgjedhjeve nuk është bërë në mënyrë adekuate më parë. Ndaj, për këtë arsye, konsiderojmë që ky rekomandim që e kemi dhënë, do të duhej të përkrahej, sepse jep një pasqyrë shumë të mirë të votuesve që kanë votuar dhe që e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë jashtë vendit. Mirëpo, ky ka qenë qëllimi, sepse ne nuk kemi pasur mundësi të japim një shifër të saktë, për të siguruar të gjithë ne që jemi këtu se a janë të pakontestueshme dhe të verifikuara. Në mungesë të kësaj, kemi dhënë qëndrimin që ato do të duhej të jenë më transparente, në mënyrë që qytetarët të jenë në dijeni se sa ka qenë numri i votuesve jashtë vendit dhe sa e kanë shfrytëzuar atje këtë drejtë.

Shkumbin Demaliaj, tha se është një e drejtë e pakontestueshme e votuesve dhe e qytetarëve të Kosovës, për të votuar dhe mundësia e lehtësisht më të mirë, duke dhënë besimin e vet, lidhur me atë që e ka të garantuar me ligjet e Kosovës. Po ashtu, tha se historikisht e kemi pasur këtë problem, të cilin e kemi trashëguar nga OSBE-ja, që në zgjedhjet e para dhe Kosova ka nevojë për një reformë të thellë zgjedhore, për t'i përcaktuar të gjitha këto dispozita që ju i keni hasur në kundërshtim me konventa, por edhe me parimet e komisioneve të ndryshme, në këtë rast, si ai i Venedikut.

Sami Kurteshi, tha se rekomandimi kryesor është shumë i drejtë. Sa i përket rekomandimit të Avokatit të Popullit, pajtohem plotësisht që përmes ligjit të njihet e drejta e votimit fizik në vendet ku ata jetojnë. Kemi shtete që janë shumë të interesuara, që ta ndihmojnë procesin e votimit edhe në forma tjera dhe një prej tyre është Zvicra, sepse ata e kanë shumë të zhvilluar referendumin, zgjedhjet e shpeshta e bëjnë një promovim të drejtës së votës në krejt botën, sidomos në Evropë, përmes Këshillit të Evropës. Ndër tjera, z. Kurteshi tha se Ministria e Punëve të Jashtme e Kosovës mund të kërkojë ndihmë nga Ministria e Punëve të Jashtme e Zvicrës, për votimin e bashkatdhetarëve atje dhe ata janë të gatshëm të ndihmojnë, sepse kanë ndihmuar edhe në raste tjera, shtete tjera. Po ashtu, tha se është më e kufizuar në Gjermani dhe në Austri, mirëpo kjo është e mundshme, sepse nuk ka asnjë pengesë politike dhe as juridike. Në fund, tha se do të punojmë së bashku me anëtarët e komisionit, që t'ua mundësojmë bashkë atdhetarëve tanë votimin fizik atje dhe mos të përballen me këto probleme.

Hajdar Beqa, tha se ne e kemi shqyrtuar raportin dhe është për t'u vlerësuar, ngase është një raport i saktë dhe përmbajtësor, duke pohuar se rregullon një çështje që është në interes të qytetarëve tanë që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës. Numri i qytetarëve tanë që jetojnë jashtë vendit, është shumë madh, ndërsa numri që votojnë është shumë vogël. Kjo për faktin se

forma e votimit përmes postës nuk është shumë demokratike, duke u bazuar te familjarët, miqtë që jetojnë atje. Po ashtu, tha se e kemi të domosdoshme që të bëjmë më shumë për diasporën, duke pasur parasysh kontributin që kanë dhënë për lirinë e vendit, për zhvillimin ekonomik, për integrimin e vendit dhe kjo është njëra prej atyre që t'i përkrahim këto rekomandimet e Avokatit të Popullit, për plotësim- ndryshimet e ligjeve në fjalë. Gjithashtu, theksoi se duhet të shikojmë rrugë, që të kemi edhe deputetë në Kuvendin e Kosovës, nga diaspora, duke pohuar se do të jetë një vlerë e shtuar për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ndaj kjo është një mënyrë që edhe të zgjedhin, por edhe të zgjidhen, si përfaqësues të diasporës.

Bilal Sherifi, tha se për dallim nga shtetasi i Republikës së Kosovës, ai që jeton jashtë duhet të aplikojë për të ushtruar të drejtën e votës dhe t'i nënshtrohet një procesi të gjatë të verifikimit dhe këtu është i gjithë problemi që iu del atyre, për të votuar. Ne duhet t'i lehtësojmë procedurat e votimit, duke i thjeshtësuar sa më shumë procedurat për bashkatdhetarët tanë, ku votat që vijnë me postë do të duhej t'i nënshtrohen komisionit, ashtu sikur votuesi të jetë prezent në Kosovë nga diaspora. Shumica e bashkë atdhetarëve dekurajohen nga procesi i gjatë i verifikimit të identitetit të tyre dhe nuk i hyjnë fare kësaj procedure sepse është i gjatë, pra ne duhet të gjejmë konsensus si ti lehtësojmë procedurat përmes ligjit. Po ashtu, shtroi pyetjen se si mund ta përballojë shteti i Kosovës votimin në ambasada dhe a është e mundur që të administrohet një proces i votimit në Ambasadë. Edhe nëse nuk mundemi ta dërgojmë rutinë tek ata ne mundemi përmes ligjit për zgjedhjet të lehtësojmë procedurën e verifikimit se kush po voton. Por mënyra më e mirë do të ishte që të organizohen zgjedhjet nga Shteti i Kosovës nëpër Ambasadat ku ata jetojnë cilat ata jetojnë mirëpo nëse kjo nuk është e mundur atëherë së paku të bëhet thjeshtësimi i procedurave.

Korab Sejdiu, tha se raporti na jep udhëzimin sesi të veprojmë, për të adresuar këtë çështje. Po ashtu, z. Sejdiu propozoi që sot të merret një vendim nga komisioni për një iniciativë legjislative të komisionit, për të ndryshuar Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme dhe të adresojë ekskluzivisht çështjet që ngrihen nga rekomandimi i Avokatit të Popullit, që kanë të bëjnë me votimin jashtë vendit. Pra, të jetë e kufizuar në këto çështje, sepse në momentin që hapen tema tjera, e fundosin këtë nismë legjislative, ngase nuk ka pasur vullnet për të ndërmarrë veprime të tilla. Fillimisht, të krijojmë grupin hartues, për të hartuar projektligjin për ndryshim dhe plotësim të ligjit, më pas e procedojmë tutje për seancë plenare. Në fund, tha se ky është një hap shumë i rëndësishëm, për të bërë një përmirësim sado të vogël në jetën e bashkatdhetarëve tanë, që jetojnë në diasporë.

Hilmi Jashari, i falënderoi të gjithë për përkrahjen dhe theksoi se ky ka qenë synimi i tyre, kur e kanë nisur këtë raport, për ta ndihmuar Kuvendin për të sjellë pajtueshmëri për këto ligje që janë nxjerrë me standarde ndërkombëtare. Gjithmonë, duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm, për të cilin edhe janë të zotuar. Po ashtu, tha se ju e jetësoni edhe frymën Ligjit të Avokatit të Popullit, sepse këto rekomandime, nëse mbesin thjeshtë si raporte, nuk e arrijnë qëllimin filozofik, për të cilën është themeluar institucioni, duke besuar që është në interesin e qytetarëve të Kosovës, për të pasur mundësi më të mira vendimmarrjeje, në çështje të interesit të përgjithshëm.

Kryetarja theksoi se propozimi është që të merret një vendim dhe më pas të formohet një grup i punës për këtë nismë legjislative, sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit, për plotësim-ndryshimin e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me **6 vota për, asnjë votë kundër dhe 1 votë abstenim**, nxori këtë:

V E N D I M

1. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, vendosi të hartojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Ligjit nr. 03/L-072 për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, sipas raportit me rekomandime të Avokatit të Popullit, nr. 687/2017.
2. Formohet grupi i punës në hartimin e projektligjeve, më këtë përbërje:
 - Korab Sejdiu- kryesues
 - Sami Kurteshi- anëtar
 - Albulena Haxhiu- anëtare
 - Hajdar Beqa- anëtar dhe
 - Bilall Sherifi- anëtar

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit funksional për Projektligjin nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit

Kryetarja paraqiti për shqyrtim, para komisionit, raportin me amendamente të Komisionit funksional për Projektligjin nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, njëzëri, vendosi që Komisionit funksional t’ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 06/L-033 për produkte të ndërtimit, është në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji mund t’i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

5. Të ndryshme

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu